

**FORMULARI I MIRATIMIT PËR SHKËMBIM TË INFORMACIONIT SHËNDETËSOR, "KUJDES KUDO (CARE EVERYWHERE)" DHE "HEALTHIX" HEALTH INFORMATION EXCHANGE, CARE EVERYWHERE AND HEALTHIX CONSENT FORM**

Në këtë formular miratimi, mund të zgjidhni nëse dëshironi t'i lejoni ofruesit e kujdesit shëndetësor të listuar në faqen e internetit të shkëmbimit të informacionit shëndetësor (në vijim "HIE") të sistemit shëndetësor në Universitetin "Langone" të Nju-Jorkut (NYU Langone Health System) <http://health-connect.med.nyu.edu/> (në vijim "pjesëtarët e HIE") dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor që nuk janë të Universitetit "Langone" të Nju-Jorkut (NYU Langone) që mund të kërkojnë akses në të dhënat tuaja mjekësore për qëllime trajtimi mjekësor (në vijim "ofruesit e 'Kujdes kudo (Care Everywhere)') të kenë akses në të dhënat tuaja mjekësore nëpërmjet një rrjeti kompjuterik të operuar nga HIE. Në mënyrë që një ofruesit e "Kujdes kudo (Care Everywhere)" të jenë në dijeni të informacionit të disponueshëm nëpërmjet HIE, duhet t'i vini në dijeni që keni qenë/jeni pacient i një pjesëtarit të HIE dhe se një informacioni i tillë mund të jepet sipas kërkesës. Kjo mund të ndihmojë në mbledhjen e të dhënave mjekësore që keni në vende të ndryshme ku merrni kujdes mjekësor dhe vendosjen e tyre në dispozicion të ofruesve që ju trajtojnë.

In this Consent Form, you can choose whether to allow the health care providers listed on the NYU Langone Health System Health Information Exchange ("HIE") website <http://health-connect.med.nyu.edu/> ("HIE Participants") and non-NYU Langone health providers who may request access to your medical records for purposes of current treatment ("Care Everywhere Providers") to obtain access to your medical records through a computer network operated by the HIE. In order for a Care Everywhere Provider to know that information may be available through the HIE, you must tell them that you were/are a patient of an HIE Participant and that such information may be available upon request. This can help collect the medical records you have in different places where you get health care, and make them available to the providers treating you.

Gjithashtu, mund ta përdorni këtë formular miratimi për të vendosur nëse do t'i lejoni punonjësit, agjentët apo anëtarët e stafit mjekësor të sistemit shëndetësor në Universitetin "Langone" të Nju-Jorkut (NYU Langone Health System) dhe subjektet e lidhura me të, të shohin dhe të kenë akses në të dhënat tuaja shëndetësore elektronike nëpërmjet "Healthix", e cila është një organizatë për shkëmbimin e informacionit shëndetësor, ose një organizatë rajonale e informacionit shëndetësor, ose një organizatë jofitimprurëse e njohur nga shteti i Nju-Jorkut. Kjo mund të ndihmojë gjithashtu në mbledhjen e të dhënave tuaja mjekësore nga vende të ndryshme ku merrni kujdes mjekësor dhe vënien e tyre në dispozicion të ofruesve të kujdesit që ju trajtojnë, në mënyrë elektronike. Po ashtu, nëpërmjet këtij miratimi, autorizoni çdo program të sistemit shëndetësor në Universitetin "Langone" të Nju-Jorkut (NYU Langone Health System) dhe të subjekteve të lidhura me të, në të cilat jeni pacient ose anëtar, të ketë akses në të dhënat tuaja nga ofrues të tjerë shëndetësorë të autorizuar për të dhënë informacion nëpërmjet "Healthix". "Healthix" vë në dispozicion një listë të plotë të burimeve të tij aktuale të informacionit, e cila mund të merret në çdo kohë duke kontrolluar në faqen e internetit të "Healthix" në <http://www.healthix.org> ose duke telefonuar 877-695-4749. Ofruesi juaj do ta printojë këtë listë për ju nga kjo faqe interneti, sipas kërkesës.

You may also use this Consent Form to decide whether or not to allow employees, agents or members of the medical staffs of NYU Langone Health System and affiliated entities to see and obtain access to your electronic health records through Healthix, which is a Health Information Exchange, or Regional Health Information Organization, a not-for-profit organization recognized by the state of New York. This can also help collect the medical records you have in different places where you get healthcare, and make them available electronically to the providers treating you. This consent also gives your permission for any NYU Langone Health System and affiliated entities program in which you are a patient or member, to access your records from your other healthcare providers authorized to disclose information through Healthix. A complete list of current Healthix Information Sources is available from Healthix and can be obtained at any time by checking the Healthix website at <http://www.healthix.org> or by calling 877-695-4749. Upon request, your provider will print this list for you from this website.

**ZGJEDHJA JUAJ NUK DO TË PREKË MUNDËSINË TUAJ PËR TË MARRË KUJDES MJEKËSOR APO MBULIM ME SIGURIM SHËNDETËSOR. ZGJEDHJA JUAJ PËR TË DHËNË APO REFUZUAR MIRATIMIN NUK BËHET SHKAK PËR REFUZIM TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE.**

**YOUR CHOICE WILL NOT AFFECT YOUR ABILITY TO GET MEDICAL CARE OR HEALTH INSURANCE COVERAGE. YOUR CHOICE TO GIVE OR TO DENY CONSENT MAY NOT BE THE BASIS FOR DENIAL OF HEALTH SERVICES.**

HIE dhe "Healthix" shkëmbejnë informacion për shëndetin e njerëzve në mënyrë elektronike dhe të sigurt, për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Ky lloj shkëmbimi quhet "ehealth" ose teknologjia e informacionit shëndetësor. Për të mësuar më tepër për "ehealth" në Shtetin e Nju-Jorkut, lexoni broshurën "Informacion më i mirë do të thotë shëndet më i mirë (Better Information Means Better Care)". Këtë mund t'ia kërkonti ofruesit tuaj të kujdesit shëndetësor, ose ta gjeni në faqen e internetit [www.ehealth4ny.org](http://www.ehealth4ny.org).

The HIE and Healthix share information about people's health electronically and securely to improve the quality of health care services. This kind of sharing is called ehealth or health information technology. To learn more about ehealth in New York State, read the brochure, "Better Information Means Better Care". You can ask your health care provider for it, or go to the website [www.ehealth4ny.org](http://www.ehealth4ny.org).

**LEXONI ME KUJDES INFORMACIONIN NË FLETËN E FAKTEVE PËRPARA SE TË VENDOSNI. Zgjedhjet për miratim.** Këtë formular mund ta plotësoni tani ose në të ardhmen. Keni zgjedhjet e mëposhtme:

**PLEASE CAREFULLY READ THE INFORMATION ON THE FACT SHEET BEFORE MAKING YOUR DECISION. Your Consent Choices.** You can fill out this form now or in the future. You have the following choices:

Zgjidhni një kuti  më poshtë:

Please check one box  below:

1. **JAP MIRATIMIN** që të GJITHË pjesëtarët e HIE të listuar në faqen e internetit të HIE dhe ofruesit e "Kujdes kudo (Care Everywhere)", të kenë akses në GJITHË informacionin tim shëndetësor elektronik nëpërmjet HIE dhe **JAP MIRATIMIN** që të GJITHË punonjësit, agjentët dhe anëtarët e stafeve mjekësore të sistemit shëndetësor në Universitetin "Langone" të Nju-Jorkut (NYU Langone Health System) dhe të subjekteve të lidhura me të, të kenë akses në të GJITHË informacionin tim shëndetësor elektronik nëpërmjet "HEALTHIX" në lidhje me secilin nga qëllimet e lejuara që përshkruhen në fletën e fakteve, duke përfshirë ofrimin e çdo shërbimi të kujdesit mjekësor, duke përfshirë kujdesin e urgjencës.

1. **I GIVE CONSENT** to ALL of the HIE Participants **listed on the HIE website** and Care Everywhere Providers to access ALL of my electronic health information through the HIE and **I GIVE CONSENT** to ALL employees, agents and members of the medical staffs of NYU Langone Health System and affiliated entities to access ALL of my electronic health information through HEALTHIX in connection with any of the permitted purposes described in the fact sheet, including providing me any health care services, including emergency care.

2. **NUK JAP MIRATIMIN** që pjesëtarët e HIE të listuar në faqen e internetit të HIE ofruesit e "Kujdes kudo (Care Everywhere)", të kenë akses në informacionin tim shëndetësor elektronik nëpërmjet HIE dhe **NUK JAP MIRATIMIN** që punonjësit, agjentët dhe anëtarët e stafeve mjekësore të sistemit shëndetësor në Universitetin "Langone" të Nju-Jorkut (NYU Langone Health System) dhe të subjekteve të lidhura me të të kenë akses në informacionin tim shëndetësor elektronik nëpërmjet "HEALTHIX" për çfarëdo qëllimi, edhe në raste emergjencash mjekësore.

2. **I DENY CONSENT** to the HIE Participants **listed on the HIE website** and Care Everywhere Providers to access my electronic health information through the HIE and **I DENY CONSENT** to employees, agents and members of the medical staffs of NYU Langone Health System and affiliated entities to access my electronic health information through HEALTHIX for any purpose, *even in a medical emergency*.

SHËNIM: NË RAST SE NUK ZGJIDHNI KUTINË "NUK JAP MIRATIMIN", ligji i Shtetit të Nju-Jorkut u lejon njerëzve që do t'ju japin trajtim mjekësor në rast emergjence të kenë akses në të dhënat tuaja shëndetësore, duke përfshirë ato që vihen në dispozicion nëpërmjet HIE dhe "HEALTHIX". NËSE NUK BËNI ASNJË ZGJEDHJE, të dhënat nuk ndahen me të tjerë, përveçse në rast emergjence, siç lejohet nga legjisllacioni i Shtetit të Nju-Jorkut.

NOTE: UNLESS YOU CHECK THE "I DENY CONSENT" BOX, New York State law allows the people treating you in an emergency to get access to your medical records, including records that are available through the HIE and HEALTHIX. IF YOU DON'T MAKE A CHOICE, the records will not be shared except in an emergency as allowed by New York State Law.

---

Emri i pacientit me germa të mëdha  
Print Name of Patient

---

Nënshkrimi i pacientit ose i përfaqësuesit ligjor  
të pacientit  
Signature of Patient or Patient's Legal  
Representative

---

Datëlindja e pacientit  
Patient's Date of Birth

---

Data  
Date

---

Emri i përfaqësuesit ligjor me germa të mëdha dhe lidhja  
me pacientin (sipas rastit)  
Print Name of Legal Representative and Relationship (if  
applicable)

# HIE e Universitetit "Langone" të Nju-Jorkut (NYU Langone), "Kujdes kudo (Care Everywhere)" dhe "Healthix" Fleta e fakteve

Detaje për informacionin e pacientit të shkëmbyer nëpërmjet HIE, "Kujdes kudo (Care Everywhere)" dhe "Healthix" dhe procesi i dhënies së miratimit:

- 1. Si do të përdoret informacioni juaj.** Informacioni juaj shëndetësor elektronik do të përdoret nga pjesëtarët e HIE dhe ofruesit e "Kujdes kudo (Care Everywhere)" vetëm për të:
  - ofruar trajtim mjekësor dhe shërbime të lidhura me të;
  - verifikuar nëse keni sigurim shëndetësor dhe çfarë mbulon ai;
  - vlerësuar dhe përmirësuar cilësinë e kujdesit mjekësor që u ofrohet të gjithë pacientëve.

Përveç rasteve kur lejohet ndryshe nga legjislacioni shtetëror dhe federal dhe nëse lejohet nga "Healthix", informacioni juaj shëndetësor elektronik do të zbulohet, aksesohet dhe përdoret nga planet e sigurimit të kujdesit shëndetësor të sistemit shëndetësor në Universitetin "Langone" të Nju-Jorkut (NYU Langone Health) vetëm për të:

- Ofruar shërbime për menaxhimin e kujdesit. Këto përfshijnë ndihmën në marrjen e kujdesit të duhur mjekësor, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor që ju ofrohen, koordinimin e ofrimit të shërbimeve të shumta të kujdesit shëndetësor që ju ofrohen, ose mbështetjen në ndjekjen e një plani të kujdesit mjekësor.
- Ofruar shërbime për përmirësimin e cilësisë. Këto përfshijnë vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së kujdesit mjekësor që ju ofrohet ju dhe të gjithë pacientëve e anëtarëve të sistemit shëndetësor të Universitetit "Langone" të Nju-Jorkut (NYU Langone Health).

**SHËNIM: Zgjedhja që bëni në këtë formular miratimi NUK u lejon siguriesve shëndetësorë të kenë akses në informacionin tuaj me qëllim vendimmarrjeje për t'ju ofruar sigurim shëndetësor apo për t'ju paguar faturat. Zgjedhjen mund ta bëni në një formular të veçantë miratimi që duhet të përdorin siguriesit shëndetësorë.**

- 2. Çfarë llojesh informacioni rreth jush përfshihen.** Nëse jepni miratimin, pjesëtarët e HIE dhe ofruesit e "Kujdes kudo (Care Everywhere)" mund të kenë akses në të GJITHË informacion tuaj shëndetësor elektronik që vihet në dispozicion nëpërmjet HIE dhe të gjithë punonjësit, agjentët dhe anëtarët e stafit mjekësor të sistemit shëndetësor të Universitetit "Langone" të Nju-Jorkut (NYU Langone Health System) dhe të subjekteve të lidhura me të, mund të kenë akses në të GJITHË informacionin tuaj shëndetësor elektronik që vihet në dispozicion nëpërmjet "Healthix". Kjo përfshin informacionin e krijuar përpara dhe pas datës së këtij formulari miratimi. Të dhënat tuaja shëndetësore mund të përfshijnë një historik sëmundjesh apo lëndimesh që keni pasur (si diabeti apo thyerje kocke), rezultate analizash (si rreze rëntgen apo analiza gjaku) dhe lista të barnave që keni përdorur. Ky informacion mund të lidhet me gjendje të ndjeshme shëndetësore, duke përfshirë, por jo vetëm:

<ul style="list-style-type: none"><li>• Probleme të përdorimit të alkoolit dhe të drogës duke përfshirë, por jo vetëm, diagnozën, mjekimin, informacion mbi diagnozën, historikun dhe përmbledhjet, shënimet klinike dhe përmbledhjen e daljes nga spitali</li><li>• Kontrollin e lindjeve dhe abortin (planifikimi familjar)</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Trajtimin për shëndetin mendor</li><li>• Alergjitë</li><li>• Sëmundjet gjenetike (të trashëguara) ose analiza</li><li>• Sëmundjet seksualisht të transmetueshme</li><li>• HIV/SIDA</li></ul>
---	--

- 3. Nga vjen informacioni juaj shëndetësor.** Informacioni juaj vjen nga vende që ju kanë ofruar kujdes shëndetësor ose sigurim shëndetësor (në vijim "burimet e informacionit"). Këto mund të përfshijnë spitalet, mjekët, farmacitë, laboratorët klinikë, siguruesit shëndetësorë, programin "Medicaid" dhe organizata të tjera të "ehealth" që shkëmbejnë informacion shëndetësor në mënyrë elektronike. Një listë e plotë e burimeve aktuale të informacionit të HIE ndodhet në sistemin shëndetësor të Universitetit "Langone" të Nju-Jorkut (NYU Langone Health System) ose tek ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor pjesëmarrës në HIE, sipas rastit. Mund të merrni në çdo kohë një listë të përditësuar të burimeve të informacionit, duke kontrolluar faqen e internetit të HIE <http://health-connect.med.nyu.edu/>. **Mund të kontaktoni me përgjegjësin e privatësisë (Privacy Officer) së Universitetit "Langone" të Nju-Jorkut (NYU Langone Health) duke shkruar në adresën: NYU Langone Health, Privacy Officer, One Park Ave, 3<sup>rd</sup> Floor, New York, NY 10016; ose duke telefonuar 212-404-4079. "Healthix" vë në dispozicion një listë të plotë të burimeve të tij aktuale të informacionit, e cila mund të merret në çdo kohë duke kontrolluar në faqen e internetit të "Healthix" në <http://www.healthix.org> ose duke telefonuar "Healthix" në 877-695-4749.**
- 4. Kush mund të ketë akses në informacionin tuaj nëse jepni miratimin.** "Sistemi shëndetësor i Universitetit 'Langone' të Nju-Jorkut (NYU Langone Health System) dhe filialet" siç përdoret në këtë formular miratimi, përfshin spitalet, fakultetin e mjekësisë, qendrat shëndetësore për familjet të Universitetit "Langone" të Nju-Jorkut (NYU Langone) dhe spitalin e filialet mjekësore të Universitetit "Winthrop" të Nju-Jorkut (NYU Winthrop). Vetëm këta persona nga këto vende mund të kenë akses në informacionin tuaj: mjekët dhe ofruesit e tjerë të kujdesit shëndetësor që shërbejnë në stafin mjekësor të një pjesëmarrësi të miratuar të HIE, pjesëmarrësi të "Healthix" apo ofruesit të "Kujdes kudo (Care Everywhere)", të cilët marrin pjesë në kujdesin tuaj mjekësor; ofruesit e kujdesit mjekësor që mbulojnë apo janë në gatishmëri për një pjesëmarrës të miratuar të HIE ose mjekët e ofruesit të "Kujdes kudo (Care Everywhere)"; stafi i caktuar që merret me përmirësimin e cilësisë apo aktivitetet e menaxhimit të kujdesit; dhe anëtarët e stafit të një pjesëmarrësi të miratuar të HIE ose një ofrues i "Kujdes kudo (Care Everywhere)", të cilët kryejnë aktivitete të lejuara nga ky formular miratimi, sipas përshkrimit në paragrafin një më lart.
- 5. Masat ndëshkuese në rast aksesi ose përdorimi të papërshtatshëm të informacionit tuaj.** Në rast aksesi ose përdorimi të papërshtatshëm të informacionit tuaj shëndetësor elektronik merren masa ndëshkuese. Nëse dyshoni në çfarëdo momenti se dikush që nuk duhet të shohë apo të ketë akses në informacionin tuaj e ka bërë diçka të tillë, telefononi një nga pjesëmarrësit e HIE apo ofruesit e "Kujdes kudo (Care Everywhere)" të cilët kanë miratimin tuaj për të aksesuar të dhënat tuaja; vizitoni faqen e internetit të HIE: <http://health-connect.med.nyu.edu/> ose telefonojini Departamentit të Shëndetit të Shtetit të Nju-Jorkut (NYS Department of Health) në numrin 877-690-2211. Nëse dyshoni në çfarëdo momenti se dikush që nuk duhet shohë apo të ketë akses në informacionin tuaj e ka bërë diçka të tillë nëpërmjet "Healthix", telefonojini "Healthix" në numrin: 877-695-4749; ose vizitoni faqen e internetit të "Healthix": <http://www.healthix.org>; ose telefonojini Departamentit të Shëndetit të Shtetit të Nju-Jorkut (NYS Department of Health) në numrin 877-690-2211.
- 6. Ridhënia e informacionit.** Çdo informacion juaj shëndetësor elektronik mund të rijepet nga një pjesëmarrës në HIE apo ofrues i "Kujdes kudo (Care Everywhere)" për të tjerët, deri në masën e lejuar nga legjislacioni dhe rregullat e shtetit dhe ato federale. Kjo vlen edhe për informacionin tuaj shëndetësor të përmbajtur në dokumente fizike. Siç u përmend në pikën 2 më lart, nëse jepni miratimin tuaj, i GJITHË informacioni juaj shëndetësor elektronik, duke përfshirë informacionet shëndetësore të natyrës delikate do të vihen në dispozicion nëpërmjet HIE dhe "Healthix". Disa ligje shtetërore dhe federale sigurojnë mbrojtje të veçantë për disa lloje informacioni delikat, duke përfshirë ato të lidhura me: I. vlerësimin, trajtimin apo ekzaminimin e një gjendjeje shëndetësore nga ofrues të caktuar; II. HIV/SIDA; III. sëmundje mendore; IV. vonesë mendore dhe aftësi të kufizuar në zhvillim; V. abuzim me substancat; dhe VI. analiza gjenetike për predispozicionin. Kërkesat e tyre të veçanta duhet të ndiqen kurdo që njerëzit marrin këto lloj informacioni delikat shëndetësor. HIE, "Healthix" dhe personat, duke përfshirë ofruesit e "Kujdes kudo (Care Everywhere)", që kanë akses në këtë informacion nëpërmjet këtyre shkëmbimeve të informacionit shëndetësor, duhet të përmbushin këto kërkesa.
- 7. Periudha e zbatimit.** Ky formular miratimi mbetet në fuqi deri në ditën e anulimit të tij nga ana juaj ose deri në çastin kur HIE pushon së ekzistuari, ose deri në 50 vjet pas vdekjes suaj, cilado të ndodhë më vonë.

8. **Anulimi i miratimit.** Miratimin mund ta anuloni në çdo kohë duke nënshkruar një formular të ri miratimi dhe duke zgjedhur **NUK JAP MIRATIMIN**. Këta formularë mund t'i gjeni në faqen e internetit të HIE <http://health-connect.med.nyu.edu/>. Pasi t'i plotësoni, dërgojini me faks në numrin 917-829-2096 ose dorëzojini tek ofruesi juaj.

**Shënim: Organizatat, duke përfshirë ofruesit e "Kujdesit kudo (Care Everywhere)", që kanë akses në informacionin tuaj shëndetësor nëpërmjet HIE dhe/ose "Healthix" ndërsa miratimi juaj është në fuqi, mund të kopjojnë apo ta përfshijnë informacionin tuaj në regjistrat e tyre mjekësorë. Edhe nëse më vonë vendosni ta anuloni miratimin tuaj, ata nuk janë të detyruar ta reregjistrojnë apo ta heqin nga regjistrat e tyre.**

9. **Refuzimi për të zgjedhur një kuti (për të bërë një zgjedhje).** Në rast se nuk zgjidhni kutinë "**NUK JAP MIRATIMIN**", legjisllacioni i Shtetit të Nju-Jorkut u lejon njerëzve që do t'ju japin trajtim mjekësor në rast emergjence, që të kenë akses në të dhënat tuaja shëndetësore, duke përfshirë ato që vihen në dispozicion nëpërmjet HIE. Nëse nuk bëni asnjë zgjedhje, të dhënat nuk ndahen me të tjerë, përveçse në rast emergjence, siç lejohet nga legjisllacioni i Shtetit të Nju-Jorkut.
10. **Kopja e formularit.** Keni të drejtë të merrni një kopje të këtij formulari miratimi pasi ta firmosni.
11. **Rreziqet e mosdhënies së miratimit.** Nëse nuk jepni miratim që pjesëtarët e HIE dhe ofruesit e "Kujdesit kudo (Care Everywhere)" të kenë akses në informacionin tuaj nëpërmjet HIE dhe "Healthix", ofruesit tuaj të kujdesit mjekësor mund të mos kenë mundësi aksesi në kohën e duhur në informacionin tuaj kritik shëndetësor që mund të jetë përftuar në raste të mëparshme.